



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
GJIROKASTËR

Nr 1093 Prot.

Gjirokastër, më 14/12/2016.


**URDHËR**

**PËR FILLIMIN E PROCESIT TË ZGJEDHJES SË ANËTARËVE PËRFAQËSUES TË  
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" NË BORDIN E ADMINISTRIMIT**

Në mbështetje të nenit 48 pikat 1, 2 dhe 6 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe në nenin 11 pika 7 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej",

**URDHËROJ:**

1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar i Universitetit "Eqrem Çabej", ka të drejtë që nga ora 8<sup>00</sup> e datës 14.12.2016 dhe deri më datë 16.12.2016 ora 14<sup>00</sup>, të regjistrohet pranë sekretares së Rektorit, si kandidatë për anëtar përfaqësues i institucionit në Bordin e Administrimit.
2. Numri i vendeve për anëtarë Bordi të Administrimit, përfaqësues të institucionit është tre.
3. Personeli akademik i interesuar vetëkandidohet ose propozohet nga njësi bazë të cilës i përket.
4. Nuk lejohet kandidimi për vendin e anëtarit të Bordit të Administrimit, i Rektorit, Dekanit, Përgjegjësit të Departamentit dhe Administratorit.
5. Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim:
  - a. përshkrim jetësor i kandidatit;
  - b. kopje e kartës së identitetit;
  - c. vërtetim i marrëdhënieve të punës, ku të përcaktohet titulli/grada/diploma, kohëzgjatja e marrëdhënieve të punës dhe ngarkesa me kohë të plotë;
  - d. personeli që vetëkandidon i shoqëron dokumentat e mësipërme me kërkesën për vetëkandidim;
  - e. personeli që propozohet nga njësi bazë duhet të marri mbështetjen e më shumë së gjysmës së anëtarëve të departamentit. Propozimi me firma i kësaj shumice i përcillet sekretares së Rektorit nga Përgjegjësi i Departamentit me shkresë përcjellëse së bashku me dokumentat e kandidatit. Njësi bazë mund të propozojë vetëm një kandidatë për anëtarë bordi.
6. Lista me kandidatët e propozuar apo vetëkandiduar për anëtarë Bordi Administrimi i përcillet Senatit Akademik brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit të caktuar në pikën 1 të këtij urdhri.







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
GJIROKASTËR

7. Senati Akademik me votim të fshehtë përzgjedh nga lista e kandidaturave 3 anëtarët e Universitetit "Eqrem Çabej" në Bordin e Administrimit. Anëtari i Senatit Akademik ka të drejtë të votojë për jo më shumë se tre kandidatë. Tre kandidatët me më shumë vota shpallen të zgjedhur.
8. Ky urdhër hyn në fuqi pas shpalljes së tij.

Prof.Dr Bektash MEMA

REKTOR

